



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1259/2 prot.,

Datë 02.06.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF në procedurën e prokurimit “*E hapur , Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “*SHËRBIM AKOMODIM PERSONEL*”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF  
*Adresa: Lagjja "Mbrostar", Ura "Rruga Fier-Tiranë" Kilometri i tretë, Fier.*

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal Memorial Fier  
*Adresa: Qender, Afrimi i Ri, Rruga “Daullas Grecalli” Nr 17, Daullas, Fier.*

Në datën 01.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1259 prot., e operatorit ekonomik “Haxhi Shahu” PF për procedurën e prokurimit “*E hapur , Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “*SHËRBIM AKOMODIM PERSONEL*”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF kundërshton me anë të ankesës me nr. 1259 prot., datë 01.06.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

- 1. Ju nuk keni paraqitur licensen e leshuar nga Organi kompetent perkates per ushtrimin e aktivitetit , bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.89 date 01.03.1993 “Per dhenien e licensave per ushtrimin e veprimtarsie tursitike” si dhe ne Udhezimin e perbashket nr.1 date 19.05.2003 “Mbi licensimin dhe kontrollin e ushtrimit te vepirmtarise turistike” pika 1 e tij.
2. Per sherbime te ngjashme te meparshme keni paraqitur vertetim mbi permbushjen e nje kontrate, por pa u vertetuar ky fakt me kontarten dhe/ose faturat perkatese per vitin 2021.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 02.06.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**